

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pajisje të prodhuesit Siemens

- Shërbimet që duhet të ofrohen: *Mirëmbajtja full risk e pajisjeve mjekësore (lista më poshtë) që janë në përdorim në disa spitale të vendit sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.*

KONTRATA E TIPIT FULL RISK

Nr.	Pajisja dhe Spitali	Prodhuesi/Modeli	Lekë pa Tvsh 24 muaj
1	Skaner Spitali Sarandë	Siemens/SomatomSpirit2sl	
2	Skaner Qsut, Pediatri	Siemens/ Ballance	
3	Skaner Qsut, Onkologjik	Siemens/CTVirtual	
4	Skaner Qsut, Hemodinamika	Siemens/ Somatom Definition AS 64	
5	Skaner Qsut, Neurokirurgji	Siemens/Somatom Emotion	
6	Ct Skaner, Spitali "Shefqet Ndroqi"	Siemens/ Somatom Definition	
7	Angiograf, Qsut, Neurokirurgji	Siemens/Aksiom Artis DPA	
8	Angiograf, Spitali "Shefqet Ndroqi"	Siemens/ Artis Zee	
9	Shintigrafi, Spitali "Shefqet Ndroqi"	Siemens/ Symbia E Dual	
10	Akselerator, Qsut	Siemens/ Oncor Pre Scision	
11	Rezonance magnetike Spitali Shkoder	Magnetom Essenza/ Siemens	
12	Rezonance magnetike Spitali Traumes	Magnetom Essenza/ Siemens	

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, I Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të Të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një: Deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit

Te gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatëse
- Gjeneratori
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Blerja dhe furnizimi me helium për rezonancat magnetike
- Pajisja UPS i pajisjeve

- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindin nga nevojat të zëvendësohen kur defektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitetin me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvritimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve

Personeli teknik i Të Kontraktuarit do të garantojnë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia e ndërhyrjeve

I Kontraktuari do të duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda ditës së punës për pajisjet e instaluar në Tiranë dhe në distancat deri në 100 km dhe 24 ore për spitalet më larg se 100 km.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

I Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë të defektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i Kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë.

Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e shtuar ose zvogëluar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisje.